1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në

bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigojohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	Implementimi i sistemit software	1 copë			
2.	Sherbimi i skanimit dhe katalogimit te dokumentave	1 copë			
3.	Trajnim i perdoruesve	1 copë			
4	Mirembajtja e sistemit per periudhen 2 vjecare	1 copë			
	Çmimi total				_____
					-
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]/Nr.

Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike

Digjitalizimi i Arkivës

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	4
1.1.	Autoriteti Kontraktues	4
1.2.	Historiku	4
2.	OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA	5
2.1.	Objektivi i Përgjithshëm	5
2.2.	Qëllimi	5
2.3.	Rezultatet e përgjithshme që duhet të arrihen nga Kontraktori	6
3.	SUPOZIMET DHE RISQET	16
3.1.	Supozimet e Projektit	6
3.2.	Rrisqet	16
4.	QËLLIMI I PUNËS	17
4.1.	Të përgjithshme	17
4.1.1.	Hapsira gjeografike që do të mbulohet	17
4.1.2.	Grupet e synuara	7
4.1.3.	Siguria e sistemit	7
4.2.	Detyrat specifike	8
5.	LOGJISTIKA DHE KOHA	10
5.1.	Vendodhja	10
5.2.	Dita e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave	10
6.	RAPORTIMI	10
6.1.	Kërkesat e Raportimin	10
6.2.	Dorëzimi dhe miratimi i raporteve	10
7.	KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA	11
8.	MIRËMBAJTJA	11
9.	AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT	12
10.	TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT	13
11.	KËRKESAT FUNKSIONALE	13
11.1.	Kërkesat teknike për sistemin software	13
11.2.	Funksionalitete dhe Bllokskema	15

11.2.1. Arkitektura dhe përgjithsime teknike	15
11.2.2. Moduli i Arkivës Digjitale	15
11.2.3. Moduli i përdoruesve dhe të drejtave në sistem.....	16
12. HARDWARE NË FUNKSION TË PROJEKTIT	17

1. HYRJE

1.1.Përfituesi/ Autoriteti Kontraktues

Përfituesi / Autoriteti kontraktor është Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. ose ("U.K.T") SH.A.

1.2. Historiku

Shoqëria aksionare, organizohet dhe funksionon brwnnda territorit tw bashkisw në mbështetje të Ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore", të ndryshuar, rregullores së brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a, si dhe çdo akti ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a, është një institucion në përballje të vazhdueshme me ndryshime dinamike, zhvillimore, teknologjike dhe të normave dhe legjislacioneve përkatëse. Aktualisht rujtja, menaxhimi dhe i dokumenteve zyrtare dhe dosjeve bëhet vetëm në trajtë fizike (hardcopy) duke mos e ndihmuar apo lehtësuar procesin e menaxhimit të informacionit shkresor që trajtohet nga institucioni.

Mbledhja, administrimi, përpunimi, përdorimi dhe informimi mbi dokumentet e institucionit udhëhiqet nga parimet e:

- a) ligjshmërisë;
- b) mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë kombëtare;
- c) informimit të publikut me informacionin zyrtar;
- d) mbrojtjes së të dhënave personale;
- dh) mbrojtjes së të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar;
- e) transparencës;
- ë) bashkëpunimit midis institucioneve të varësisë;
- f) bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore;
- g) efijencës dhe efektivitetit.

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a, është autoriteti përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", për arkivat e saj vendore dhe arkivat në veprim të institucioneve qendrore dhe vendore lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve dhe informimin në lidhje me to. Aktualisht ("U.K.T") Sh.A, ruan një sasi të konsiderueshme dokumentesh fizike etj. Në terma sasiore, në arkivin e institucionit ruhen përafërsisht 2,000,000 (dy milion) faqe të formateve A4 dhe A3.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit nga i cili kjo kontratë do të jetë pjesë është të implementohet një sistem për arkivimin digjital të dosjeve dhe dokumenteve të cilat ruhen në arkivin e Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A, sipas specifikimeve teknike dhe kërkesave funksionale të parashikuara në këtë dokument. Institucioni, në zbatim të Vendimit Nr.710, datë 21.8.2013 , do të zhvillojë **“Digjitalim i Arkivës së Institucionit”**, që lehtëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucionit, qytetarëve dhe administratës publike. Në veçanti, Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A do të sigurojë infrastrukturën bazë të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit elektronik për të garantuar vazhdueshmërisë e punës dhe sistemin e ruajtjes së informacionit, me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit aksidental të të dhënave. Në këtë sistem duhet të migrohen të dhënat aktuale në format digjital që disponon Institucioni, duke përfshirë dokumentet e digjitalizuara.

2.2. Qëllimi

Qëllimi(et) i kësaj kontrate është/janë si më poshtë:

- Implementimi i nje sistemi informatik (*programi kompjuterik*) i cili do të shërbejë për administrimin e arkivës digjitale, me qëllim ofrimin e lehtësimit në procedurat e administrimit të dosjeve, në kërkim e përpunimin e dokumenteve arkivore.
- Sistemi që do të implementohet duhet të jetë i bazuar në standardet e përgjithshme ndërkombëtare për arkivim, dhe në Ligjin Nr. Nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”, ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2016, Flet.Zyrtare Nr.178, Faqe:12112.
- Informatizimin e procesit të digjitalizimit të arkivës së Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A:
 - Shtimi i fushave si element kërkimi dhe si të dhenë parësore për bazën e të dhënave;
 - Lehtësimin në menaxhim dhe në mirëmbajtje teknike;
 - Hedhjen dhe ruajtjen e materialeve digjitale të formateve të ndryshme dhe mundësinë e aksesit të tyre në ndërfaqen e përdoruesit sipas të roleve dhe të drejtave të tyre;
 - Ofrimi i shërbimit apo funksionimi i sistemit pa ndërprerje në ditët e punës;

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

2.3. Rezultatet e përgjithshme që duhet të arrihen nga Kontraktori

Në përfundim të projektit operatori ekonomik fitues, duhet të ketë përmbushur detyrat e listuara në vijim:

- Instalimi dhe konfigurimi i sistemit të arkivimit digjital sipas specifikimeve teknike dhe funksionaliteteve të kërkuara, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkuara. Sistemi elektronik për të ruajtur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë (letër), duhet:
- Të ketë testuar dhe korrigjuar të gjitha gabimet e dala gjatë fazës së testimit.
- Të ketë migruar me sukses të gjithë të dhënat (*baza të dhënash, imazhe apo dokumente në format .pdf, etj*), që disponohen në Institucion në sistemin e arkivimit digjital.
- Të ofrohet shërbimi gjatë ditëve dhe orëve të punës së Autoritetit Kontraktor, pa gabime.
- Trajnimi i përdoruesve.
- Dorëzim i dokumenteve dhe manualeve teknike dhe manualeve të përdorimit në gjuhën shqipe.
- Mirëmbajtjen e sistemit për një periudhë prej 2 (dy) vjeçare.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

Faktorët që supozohet se mund të kenë ndikim në ecurinë e projektit, janë të përshkruara si më poshtë:

- Niveli i angazhimit dhe mbështetjes së plotë të të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë projekt;
- Përcaktimi i saktë i të drejtave të përdoruesve në sistem;
- Implementimi bazuar në Ligjin Nr. Nr. 10 273, datë 29.4.2010 "Për dokumentin elektronik", (të ndryshuar), Ligjin Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", Ligjin Nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore", Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me Ligjin Nr.120/2014 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Legjislacionit për Krimin Kibernetik dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të përcaktuara në këto Ligje.
- Monitorimi i vazhdueshëm i sistemit edhe pas implementimit që të ruajë performancën pas shtimit të dokumenteve të digjitalizuara dhe të dhënave në sistem;

3.2. Rrisqet

Faktor kufizues/riskues që rrezikojnë mbarëvajtjen e projektit, apo që ndikojnë në mënyrën se si do të realizohet puna e planifikuar në këtë projekt janë:

- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të përfshirë, që mund të sjellë pengesa në realizimin korrekt dhe në kohë të objektivave të projektit;
- Mungesa apo mospërputhjet me ndryshimet ligjore/administrative/proceduriale për të qënë konsistent me procesin e ndjekur elektronikisht.

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të përgjithshme

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet implementimi i këtij projekti, e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen është:

1. Ligjin Nr. Nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”, (të ndryshuar), Ligjin Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Ligjin Nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”, Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me Ligjin Nr.120/2014 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Legjislacionit për Krimin Kibernetik dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të përcaktuara në këto Ligje.
2. Implementimi bazuar në Standardet e Përgjithshme Ndërkombetare për Arkivim.

4.1.1. Hapsira gjeografike që do të mbulohet

Ky sistem do të jetë i bazuar në teknologjinë web, i instaluar në datacenter e Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A. Sistemi do të jetë i përdorshëm dhe i aksesueshëm vetëm brenda rrjetit informatik të Autoritetit Kontraktor.

4.1.2. Grupet e synuara

Grupet e synuara të këtij sistemi do të jenë do të jenë punonjësit e Autoritetit Kontraktor. Përdoruesit duhet të kategorizohen në varësi të pozicionit që mbulojnë dhe funksionaliteteve apo të drejtave që do të kenë në sistem. Përdoruesit e sistemit në nivel administrator do të kenë mundësi të krijojnë përdorues të tjerë të cilët do të aksesojnë sistemin vetëm nga brenda institucionit rrjetin kompjuterik të brendshëm.

4.1.3. Siguria e sistemit

Mënyra e logimit në sistem do të jetë me emër përdoruesi dhe fjalëkalim. Asnjë përdorues nuk mund të aksesojë sistemin, pa patur kombinim të saktë përdorues dhe fjalëkalim. Përdoruesit kanë të drejta të mirëpërcaktuara në sistem sipas rolit që ata kanë. Përdoruesit kanë të drejta në sistem të përcaktuara për çdo proces dhe hap në rrjedhën e punës, ku ata kanë akses. Sistemi duhet të suportojë kredencialet (emër përdoruesi dhe fjalëkalim) për çdo përdorues dhe fjalëkalimet duhet të ruhen në format të enkriptuar në bazën e të dhënave. Sistemi duhet të mundësojë support për transferimin e sigurt të të dhënave me HTTPS/SSL dhe duhet të mundësojë mbështetje LDAP për integrimin e shërbimet e drejtorive (directory) dhe duhet të suportojë login të vetëm. Sistemi duhet të suportojë gjurmime gjithëpërfshirëse të auditimit në nivel dokumenti, skedari dhe nivele me të larta për çdo veprim të bërë nga përdorues specifikë, në një datë dhe orë të caktuar. Përdoruesit që do të kenë rolin e administratorit të sistemit do të kenë mundësi që të administrojnë rolet, përdoruesit dhe të drejtat e tyre në sistem. Ata mund të krijojnë, modifikojnë e çaktivizojnë përdoruesit ekzistues.

Sistemi që do të ndërtohet duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Vendimit Nr. 945, datë 02.11.2012, "Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore", në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

Përcaktimi i nivelit të sigurisë si dhe disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

Masa për sigurinë:

- Sistemi nuk duhet të lejojë krijimin e llogarive pa fjalëkalim;
- Administratorët nuk duhet të shikojnë fjalëkalimet e përdoruesve, pra ato duhet të ruhen të shifruar në databazë;

Opsionet:

- Grupet e përdoruesve do të jenë:
 - Administrator i sistemit;
 - Përdorues të tjerë, të ndarë sipas roleve të përcaktuara nga Administratori;
- Gjurmimi i veprimeve, detektimi dhe parandalimi i ndërhyrjeve, auditimi;

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
<input type="checkbox"/> D0	<input type="checkbox"/> I0	<input type="checkbox"/> K0	
<input type="checkbox"/> D1	<input type="checkbox"/> I1	<input type="checkbox"/> K1	<input type="checkbox"/> U
<input type="checkbox"/> D2	<input type="checkbox"/> I2	<input checked="" type="checkbox"/> K2	<input type="checkbox"/> M
<input checked="" type="checkbox"/> D3	<input checked="" type="checkbox"/> I3		<input checked="" type="checkbox"/> L

Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmeria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.

Niveli i sigurisë është i mesëm (M), nëse disponueshmeria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm.

Niveli i sigurisë është i ulët (U), nëse disponueshmeria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm.

4.2. Detyrat Specifike

Në këtë pikë është paraqitur një listë e detyrave që duhet të ndërmerren në mënyrë që të arrihen rezultatet e kontratës. Detyrat janë të listuara sipas rëndësisë ose në mënyrë kronologjike. Çdo detyrë kërkon ekspertizë specifike dhe ka të përcaktuar edhe kohën e përfundimit të saj:

Faza I - Implementimi i sistemit software:

1. Implementimi i sistemit të arkivit digjital sipas kërkesave teknike dhe funksionale të parashikuara në këtë dokument;
2. Instalimi dhe konfigurimi i sistemit të arkivit digjital në ambientin test dhe live;

Faza II - Faza e testimit të sistemit software dhe sistemit të manaxhimit të backup.

1. Testimi i të gjithë moduleve të sistemit të arkivit digjital;
2. Testimi i të gjithë funksionaliteteve të kërkuara nga AK;
3. Përpilimi i raportit final të testimit;

Faza e III – Shërbimi i skanimit dhe katalogimit të dokumenteve:

1. Skanimi i dokumenteve;
2. Katalogimi i dokumenteve sipas fushave të kërkimit;
3. Konvertimi i dokumenteve për njohjen e karaktereve (OCR);
4. Emërtimi i dokumenteve sipas nje protokollit të paracaktuar;

Faza IV - Trajnimi i përdoruesve

1. Përpilimi i manualit të trajnimit të përdoruesve.
2. Trajnimi përdoruesve me të gjithë funksionalitetet e sistemit të arkivit digjital të kërkuara nga AK.

Faza V - Marrja në dorëzim e sistemit software dhe akordimi për mënyrën e komunikimit gjatë periudhës së mirëmbajtjes.

1. Dorëzimi i sistemit.
2. Dorëzimi i manualeve të përdoruesit.

3. Dorëzimi i dokument teknik, duke përfshirë dhe kodin burim të sistemit.
4. Akordimi për mënyrën e komunikimit gjatë periudhës së mirëmbajtjes;

Faza VI - Mirëmbajtja e sistemit për periudhën 2 (dy) vjeçare

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Vendodhja e sistemit do të jetë në zyrat e Autoritetit Kontraktor.

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e implementimit të detyrave do të jetë 8 (tetë) muaj, nisur nga kjo datë dhe 2 (dy) vjet mirëmbajtja.

6. RAPORTIMI

6.1 Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në gjuhën shqipe, në original dhe *(për arsye mjedisore, kërkohet sa më pak kopje të letrës të jetë e mundur)* 2 kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 10 faqesh duhet të prodhohet pas 3 muajsh, nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, si dhe çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi Raportin Fillestar.
- **Raporti Final:** me afat 20 (njëzet) ditë para përfundimit të afatit të kontratës. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim të detajuar të sistemit të implementuar dhe dokumenteve të digjitalizuara. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

6.2 Dorëzimi dhe miratimi i raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet grupit të punës/nëpunësi i ngarkuar, për ndjekjen e zbatimit të kontratës të identifikuar në kontratë. Grupi i punës/nëpunësi i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës është përgjegjës, për aprovimin e raporteve. Autoriteti Kontraktor, duhet të realizojë aprovimin e raporteve të mësipërme brenda një afati 5 (pesë) ditor nga marrja e raportit. Nëse nuk zbatohen këto afate në kohe, atëherë raporti quhet i aprovuar automatikisht dhe vijohet me proceset e radhës.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Aktualisht sistemi nuk duhet të integrohet me sisteme të tjera të jashtme, por duhet të jetë i integruar me pajisjet e skanimit profesionale, që do të përdoren nga Kontraktuesi për kontratën.

8. MIRËMBAJTJA

Mirëmbajtja do të jetë për periudhën kohore 2 (dy) vjeçare duke nisur nga përfundimi i kontratës. Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë për një periudhë 2 (dy) vite, në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr.710, datë 21.08.2013, "Për Krijimin dhe Funkcionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit".

Shërbimi i mirëmbajtjes përveç sistemit, duhet të përfshijë dhe pajisjet e ofertuara, nëse ka të tilla. Operatori ekonomik i shpallur fitues, duhet të diskutojë me AK një axhendë periodike 3-mujore kontrollesh, si me poshtë:

- Kontroll i detajuar i gjithë log-eve të sistemit;
- Kontroll i sistemit;
- Kontroll i logeve të bazës së të dhënave;

Kategorizimi i problemeve dhe koha e përgjigjes

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre gjatë periudhës 2 (dy) vjeçare të mirëmbajtjes:

Serioziteti 1 (Kritik / i Lartë)	Serioziteti 2 (i Mesëm)	Serioziteti 3 (i Ulët)
Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrime financiare		

Mosfunksionimi i software-it krijon detyrime financiare të mëdha për përdoruesit ose rrezikon shumë aktivitetin ekonomik të përdoruesve.	Mosfunksionimi i software-it krijon detyrime financiare të konsiderueshme për përdoruesit ose rrezikon konsiderueshëm aktivitetin ekonomik të përdoruesve.	Mosfunksionimi i software-it krijon detyrime financiare minimale për përdoruesit ose rrezikon në mënyrë minimale aktivitetin ekonomik të përdoruesve.
Pezullimi i punës		
Mosfunksionimi i software-it pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.	Mosfunksionimi i software-it pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre, por janë në gjendje të realizojnë pjesën tjetër. Mund të përfshijë gjithashtu pyetje dhe përgjigje për informacion.	Mosfunksionimi i software-it pengon përdoruesit të realizojnë një pjesë të vogël të punës së tyre, por ata janë në gjendje të realizojnë pjesën tjetër.
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mosfunksionimi i aplikacionit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve.	Mosfunksionimi i aplikacionit ndikon një numër shumë të vogël të përdoruesve.	Mosfunksionimi i aplikacionit ndikon në 1 (një) ose 2 (dy) përdorues.
Zgjidhje alternative e perkohsme (Kjo ka peshën më të madhe të karakteristikave të Seriozitetit 1 dhe 2)		
Nuk ka një mënyrë alternative të perkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	Mund të ketë ose jo një mënyrë alternative të perkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	Potencialisht ekziston një mënyrë alternative e perkohshme dhe e pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
Brenda 2 (dy) orësh.	Brenda 8 (tetë) oreve ose ditën tjetër të punës.	Brenda 8 (tetë) oreve ose ditën tjetër të punës.
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë të vazhdueshme pas kontaktit të parë.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 20 ditëve të vazhdueshme të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 45 ditë kalendarike.

9. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Në këtë seksion janë listuar të gjitha fazat e projektit, sipas afatit kohor përkatës i shprehur në javë:

NR	Emërtimi i fazes/Periudha kohore	Afati i shprehur në javë
1	Faza I - Impementimi i sistemit software	6 javë
2	Faza II - Faza e testimit të sistemit software	2 javë
3	Faza e III – Shërbimi i skanimit dhe katalogimit të dokumenteve	22 javë
4	Faza IV - Trajnimi i përdoruesve	1 javë
5	Faza V - Marrja në dorëzim e sistemit software dhe akordimi për mënyrën e komunikimit gjatë periudhës së mirëmbajtjes	1 javë
6	Faza VI - Mirëmbajtja e sistemit për periudhën 2 (dy) vjeçare	2 vite

10. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Çdo e drejtë mbi kodin burim dhe/ose çdo dokumentacion (*mënyrën e konfigurimi të aplikacionit apo skica, etj.*), që ka të bëjë me zgjidhjen e ndërtuar nga kontraktuesi duhet t'i kalojë Autoritetit Kontraktues në format elektronik.

11. KËRKESAT FUNKSIONALE

11.1. Kërkesat teknike për sistemin software

Zgjidhja software duhet të jetë e bazuar në teknologjinë web dhe të ofrojë ndërfaqe të unifikuara të përdorimit. Më poshtë vijojnë kërkesat funksionale sipas moduleve përberese të identifikuara për zgjidhjen e kërkuar.

Sistemi duhet të mundësojë siguri të lartë duke ofruar monitorim dhe auditim të informacionit. Në veçanti, duhet të plotësojë kërkesat teknike si vijon:

Modularitet	Sistemi duhet të ketë minimalisht modulet: <ul style="list-style-type: none"> • moduli i arkivit digjital; • moduli i përdoruesve, i të drejtave në sistem; • moduli i kërkimit dhe filtrimit;
Arkitekture e shtresëzuar	Sistemi duhet të bazohet mbi një arkitekturë të shtresëzuar.
Arkitekture SOA	Sistemi duhet të ketë arkitekturë të orientuar drejt shërbimeve. Për realizimin e veprimeve të cilat realizohen nga GUI duhet ekspozohen web shërbime të standartit SOAP dhe REST.
Gjurmimi i veprimeve të përdoruesve	Sistemi duhet të gjurmojë dhe të ruajë veprimet e përdoruesve dhe të ofrojë mundësi të shfaqjes dhe kërkimit të tyre në menyre të thjeshta. Sistemi duhet të grupojë skedarët, sipas kategorive të tyre dhe jo sipas vendodhjes së ruajtjes.
Veprimet transaksionale	Sistemi duhet të garantojë veprime transaksionale me databazën duke ruajtur integritetin relacionar të të dhënave (<i>ruajtja e një të dhëne të behet vetëm nëse të gjitha proceset që kanë të bëjnë me të janë përfunduar me sukses</i>).
Teknologji WEB	Sistemi Operimit (OS) Windows/Linux Sistemi duhet të jetë i bazuar në teknologji me standardet Web 2.0, AJAX, JSR168 dhe duhet të jetë i aksesueshëm nga të gjithë shfletuesit e internetit në versionet e tyre më fundit si psh: Google Chrome, MS Internet Explorer, Mozilla Firefox, Safari.
Ndërfaqet e Sistemit	Ndërfaqet e sistemit duhet të jenë të thjeshta, të përshtatura me terminologjinë e duhur, si dhe të jenë në gjuhën Shqipe.
Kosto për përdorues	Sistemi nuk duhet të ketë kosto shtesë të licencimit për përdorues.
Kosto nga palë të treta	Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e operimit pa kosto për licencën software nga palë të treta në mënyrë të afatgjatë të ulen kostot operacionale të mirëmbajtjes.
Hyper V Failover Cluster	Instalimi i sistemit duhet të implementohet në Hyper V Failover Cluster në mënyrë që nëse ka një problem në një makine virtuale, atëherë automatikisht funksionon makina virtuale në një server tjetër fizik.
Bazuar në standardet ndërkombëtare dhe legjislativonin në fuqi	Sistemi duhet të përfshijë implementimin në përshtatje me standardet ndërkombëtare të përshtatjes arkivore (ISAD(G)) dhe legjislativonin në fuqi për arkivat.

Kërkim i avancuar	Motori i kërkimit të mundësojë kërkimin “full text search” dhe “linguistic search në përmbajtjen e dokumenteve (të skanuara me OCR) ose sipas fushave të kërkimit psh: në titull dosje, numër, datë, emër, mbiemër, emërtimi, fondi etj.
Rezultati i kërkimit	Rezultatet e kërkimit duhet të shfaqen në formë të kuptueshme dhe të thjeshtë për përdoruesin dhe të jenë të printueshme.
Gjurmimi i veprimeve	Sistemi duhet të sigurojë gjurmimin e veprimeve të kryera nga përdoruesit e sistemit për qëllime sigurie dhe mirëmbajtje, si dhe opsione për auditimin e sistemit duke siguruar një shtresën Konformiteti (Compliance) të proceseve dhe dokumentacionit.
Ruajtje e tentativave për akses të paautorizuar	Aksesi duhet i lejuar vetëm personave të autorizuar.

11.2. Funkcionalitete dhe Bblokskema

11.2.1. Arkitektura dhe përgjithsime teknike

Modulet e sistemit software duhet të jenë konceptualisht të ndërtuar në përputhje me nevojat e Institucionit dhe duhet të plotësojë të gjithë kërkesat në mënyrë gjithëpërfshirëse, të dhënat të jenë të ndërthurura mes tyre për të dhënë informacion të vlefshëm sipas kërkesave të përdoruesve, të shërbejë në veçanti për çdo përdorues dhe pozicion pune sipas rolit dhe të drejtave që ky i fundit duhet të ketë në sistem. Arkitektura e sistemit duhet të mundësojë kontrollin dhe menaxhimin e të gjithë proceseve, të informacionit dhe sigurisë së tij.

Arkitektura e instalimit duhet të jetë e përberë nga servera virtuale të instaluar në serverin fizik që do të vendosen në dispozicion nga Autoriteti. Këta servera virtual duhet të jenë të konfiguruar sipas objektivit për të cilin janë krijuar. Arkitektura logjike e sugjeruar është si vijon:

1. Serveri i aplikimeve (Application Server)

Ky server do të jetë përgjegjës për hostimin e sistemit dhe moduleve të tij për përpunimin e të dhënave.

2. Database Server (Serveri për bazën e të dhënave RDBMS)

Ky server do të kryejë funksionin serverit të bazës së të dhënave në funksion të ruajtjes dhe

disponueshmërisë së të dhënave sipas specifikave të sistemit software.

Web Browser/HTTP (Niveli i Aksesit)

Browser-i është komponenti i vetëm që përdoruesi ka nevojë të ketë të instaluar në kompjuter për të patur akses në sistem. Për shkak se të gjithë kompjuterat dhe pajisjet e lëvizshme janë të krijuar me të paktën një nga motorët standard të kërkimit (browser), përdoruesi nuk ka nevojë të instalojë asgjë në kompjuterin e tij. Kjo do të thotë që mjafton që përdoruesi të kërkojë adresën në shfletuesin e web-it.

11.2.2. Moduli i arkivës digjitale

Sistemi duhet të ofrojë një modul për arkivimin digjital të dokumenteve. Ky modul duhet të mundësojë regjistrimin e pasurisë dokumentare arkivore e cila ruhet në arkivin e Autoritetit Kontraktor, administrimin, ruajtjen dhe kërkimin për të dhëna. Regjistrimi i të dhënave arkivore duhet të mundësohet duke u bazuar në standartin ndërkombëtar të përshkrimit arkivor dhe normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Arkiva digjitale lehtëson ndarjen e informacionit midis punonjësve dhe rrit bashkëpunimin midis tyre. Në arkiven digjitale do të ruhen dokumente të ndryshme në zbatim të legjislacionit përkatës apo cdo rregullore të brendshme të institucionit.

Disa kërkesa të tjera funksionale të përgjithshme për arkivën digjitale janë:

- Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e ngarkimit, modifikimit, fshirjes, ndërrimit të nivelit ***të dokumenteve arkivore digjitale që i përkasin një dosjeve të caktuar*** sipas standarteve të përshkrimit arkivor. Këto veprime kryhen në varësi të të drejtave që kanë përdoruesit e sistemit, të miratuara paraprakisht nga strukturat përkatëse.
- Sistemi i arkivit digjital duhet të afrojë mundësinë e ruajtjes së dokumentave të tipeve të ndryshme duke përfshirë dokumente shkresore, fotografi, rregjistra, kartela etj.
- Sistemi duhet të ofrojë ruajtjen e dokumentave të madhësive të ndryshme, të grupuar sipas skemës dhe logjikës së Autoritetit Kontraktor. Ky numër nuk duhet të ndikojë në funksionimin dhe performancën e sistemit.
- Sistemi software duhet të jetë i pajisur me motor kërkimi dhe të mundësojë kërkimin për të dhëna dhe dokumente në disa forma:
 - Motori i kërkimit të mundësojë kërkimin “full text search” dhe “linguistic search në përmbajtjen e dokumenteve (*të skanuara me OCR*).
 - Motori i kërkimit të mundësojë kërkimin sipas fushave të kërkimit psh: në titull dosje, numër, datë, emer, mbiemër, emërtimi fondi etj.
- Duhet të bëjë indeksimin në nivel dokumenti në varësi të fushave përshkruese të cilat plotësohen nga përdoruesit dhe mundësojë kërkim më të shpejtë të sipas këtyre fushave.
- Duhet të bëjë indeksim të dokumenteve për aq sa është e mundur nga të dhënat e OCR të marra nga skanimi/digjitalizimi i dokumenteve arkivore.
- Sistemi duhet të jetë i integruar me pajisjet skanimit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe të jetë lehtësisht i konfigurueshëm me pajisjet skanimi që mund të përdorë në të ardhmen institucioni.
- Sistemi duhet të ofrojë ndërfaqe komunikuese për pajisjet e skanimit dhe ngarkimin e skedareve të skanuara/digjitalizuar në sistem.

11.2.3. Moduli i përdoruesve dhe të drejtave në sistem

Duke qënë se ky është një sistem gjithëpërshires për arkivën, është e rëndesishme që cdo përdorues të ketë të drejta vetëm për funksionalitetet që ky përdorues duhet të përdorë. Të gjithë përdoruesit do ta aksesojnë sistemin vetëm nepermjet rrjetit informatik të Autoritetit Kontraktor. Përmes këtij moduli administratori do të menaxhojë sistemin dhe përdoruesit. Moduli duhet të mos ketë kufizime në numrin e përdoruesve dhe të roleve.

Përdoruesit e sistemit, do të jenë:

Punonjësit e institucionit. Përdorues që do të aksesojnë sistemin me anë të emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit. Këta përdorues përbëhen nga punonjësit e Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të cilët e përdorin programin bazuar në rregulloren në fuqi të institucionit.

Administratori i sistemit. Është administratori i sistemit, specialist i departamentit të Teknologjisë së Informacionit, që kryen detyra të ndryshme si mirëmbajtje dhe menaxhim të sistemit dhe do të ketë akses te tille qe te kryeje detyrat e tij sipas rregulores ne fuqi.

Rolet e përkohëshme për shërbimin e skanimit, që do të ketë Kontraktori:

Draftues. Është përdoruesi i kontraktuesit i cili përgatit dokumentat, në bashkëpunim me punonjësit e Drejtorisë së Arkivit Qëndror dhe Protokollit.

Verifikues. Është përdoruesi i kontraktuesit, i cili verifikon saktësinë e punës së draftuesit dhe specialistëve mbështetës të institucionit.

Autorizues. Është përdoruesi i kontraktuesit, i cili autorizon që një veprim quhet i përfunduar ose që procesi të kalojë në hapin pasardhës.

12. HARDWARE NË FUNKSION TË PROJEKTIT

- Kontraktori duhet të zotërojë të paktën 2 (dy) skanera profesionalë, me këto karakteristika teknike:

Rezolucioni i skanerit:	Skanim Bardh & Zi dhe me Ngjyra në 300 dpi
Shpejtësia e skanimit:	300 dpi: 85 ipm Bardh & Zi dhe me Ngjyra Simplex/110 ipm Bardh & Zi dhe me Ngjyra i dyfishtë

Përmasat e ekranit:	Min. me gjerësi 297 mm dhe gjatësi 432 mm
Lloji i doc.të skanimit:	TIFF me një/shumë faqe, JPEG me një faqe, formatet PDF me një/shumë faqe, PDF një/shumë faqe/A OCR të integruar në serverin e skanerit.
Cikli i ditor i punës:	Min 20,000
Ndërfaqet e rrjetit:	Standard: 10BaseT/100Base-TX Ethernet (RJ-45), Ndërfaqja e hostit USB 2.0 për lidhje direkte me PC/Mac. Ndërfaqja e kartës 2.0/SD Ndërfaqja me valë IEEE 802.11a/b/g Ndërfaqja paralele IEEE 1284/ECP.
Suporti i protokollit të rrjeteve:	TCP/IP (IPv4, IPv6), IPX/SPX* Rrjeti/OS Windows XP/Vista/7/Server 2003/Server 2008/Server 2008R2, Mac OS X 10.2 ose më i ri, Novell NetWare 6.5*, Sun Solaris, HP-UX, SCO OpenServer, RedHat Linux dhe IBM AIX, SAP R/3

Shenim: Numri i Kopjeve të nevojshme për t'u dixhitalizuar është 500,000.



Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

